




Projektgruppe  
Albanische  
Familien

# TELEVIZIONI DHE FËMIJËT



## PËRPARËSITË DHE MANGËSITË INFORMACIONE PËR PRINDËR

**Fernsehen und  
kleine Kinder  
- Schaden / Nutzen -  
Tips für Eltern  
in albanischer Sprache**



Präventive  
Arbeit mit  
Migrantenfamilien

Pasqyrimi më i mirë i sjelljeve të fëmijët bëhet përmes prindërve dhe të të rriturve të tjerë me të cilët fëmijët kontaktojnë. Shpesh fëmijët marrin qëndrim të njëjtë ndaj TV ashtu sikurse prindërit. Që të arrihet edukimi i dëshiruar, prindërit duhet të sillen në mënyrë sa më të arsyeshëm në mënyrë që të kenë pasqyrë pozitive para fëmijëve dhe vetë ta pasqyrojnë atë që presin nga fëmijët e tyre.

Familjet të cilat pjesën më të madhe të kohës e kalojnë para TV-së me emisione shqipe, duhet që fëmijët t'i motivojnë të shikojnë programe për fëmijë si gjuhën shqipe ashtu edhe atë gjermane. Emisionet gjermane për fëmijë i ndihmojnë ata që të përvetësojnë gjuhën gjermane si dhe rregullat në qerdhe, në parashkollore e në shkollë ta njohë ambientin ku jetojnë dhe ta kalojnë fëmijërinë e vetë në mënyrë të rregullt.

Erstellt von / Përgatitur nga: Mislim Berisha

Herausgeber / Botues: AÇILIM - Präventive Arbeit mit  
Migrantenfamilien und  
**Vater- Mutter-Kind**  
Projektgruppe  
Albanische Familien

Bezug / Shpërndarja: AÇILIM (kostenlos / pa pagesë)

Auflage / Copë: 3000 copë  
September / Shtator 2002



### **Präventive Arbeit mit Migrantenfamilien**

Träger:

AKA - Aktiv für  
interKulturellen Austausch e.V

Zuschussgeber:

Landeshauptstadt München  
Stadtjugendamt

Rosenheimer Str. 135

81667 München

Tel: 089 – 44 11 97 80

Fax: 089 – 44 11 97 81

@: [ali.poyraz@aka-muenchen.de](mailto:ali.poyraz@aka-muenchen.de)

## **Fëmijët e vegjël e mësojnë ambientin (jetësorë) me ndihmën e shqisave: si me sy, veshë, hundë (nuhatje), gojë e duar.**

### **Fëmijët më të vegjël se 4 vjeçarë:**

- e mësojnë rrethin ku jetojnë para së gjithash përmes prekjes dhe ndjenjës,
- iu nevojitet shumë kohë që gjërat e njohura pas ndrrimit të vendit t'i njohin përsëri,
- nuk kanë mundësi ta njohin brendinë e figurës së komplikuar,
- nuk kanë mundësi ta dallojnë zhurmën dhe frigohen nga zëri i lartë i zhurmës dhe i muzikës,
- nuk i kuptojnë figurat simbolike (psh. rënja e gjetheve në vjeshtë) etj.

### **Fëmijët më të vegjël se tre vjeçarë nuk guxojnë të shikojnë televizorin:**

- nëse ata nuk janë në gjendje që të terhiqen nga shikimi i ndonjë emisioni, atëherë në asnjë mënyrë mos i leni vetëm,
- fëmijët e kësajë moshe duhet që ta njohin botën reale dhe ta ndërtojnë konceptin e mardhënieve sociale

### **Fëmijet prej 3 deri në 5 vjeçarë**

- ata ende nuk janë në gjendje ta konceptojnë një film të tërë. Skenat e vogla mund të krijojnë pershtypje të papritura tek ata.

## Fëmijët prej 5 deri në 7 vjeçarë

- Në këtë moshë zhvillohet aftësia, që filmin ta njohin në ngjyrë të kuqe. Dallimi i realitetit dhe i fiksimit edhe në këtë moshë nuk mund të bëhet.

## Nga moshja 10 vjecare


Tek në këtë moshë, fillojnë fëmijët që t'i "njohin" seritë dhe "prapaskenat". Derisa ta bejnë dallimin e realitetit dhe inskenimit zgjatë edhe 1-2 vite. Mirpo prap duhet të llogaritet me ndikime negative të filmit, te fëmijët edhe në këtë moshë.

Nuk është mirë që fëmijëve tu ofrohet shikimi i TV- së edhe nga moshja 4-5 vjecare. Megjithatë prindi ka mundësi që përmes shikimit të kontrolluar të TV-së të arrijë shumë gjëra të nevojshme t'ia mësojë femiut.

Lufta mes "të mirit" dhe "të keqit" i fascinon fëmijët. Ata luajnë role te ndryshme pastaj. Kjo është e nevojshme për zhvillimin e tyre. Prindërit nuk duhet të shqetësohen nëse fëmijët rolet e emisionit nuk i filtrojnë por i marrin ashtu si i shohin. Secili fëmijë është personalitet në vete dhe e merr temën e një emisioni në artin e personalitetit të vetë.

## Rregullat

- Kur, cilat dhe sa gjat guxojnë fëmijët ti shohin emisionet duhet të jetë e qartë për ta. Shikoni bashkarisht programin javorë dhe caktoni se cilat emisione do ti shihni javën që vjen. Asesi mos e lëshoni TV-në dhe të kërkonte se cili emision në atë moment ju pëlqen për ta parë.



- Merrni seriozisht dëshirat e fëmijëve për përcjelljen e emisioneve që janë për ta.
- Është e nevojshme që shikimi i emisioneve të TV-së të kufizohet në disa ditë të javës (në dy-tre dite). Gjeneroni emisionet e shkurtëra për t'i përcjellur. Për parashkollorët emisionet prej 30 min. janë optimale. Mos i shikoni emisionet rresht njërin pas tjetrit.
- Jo të gjitha emisionet e fëmijëve janë të përshtatshme. Shpesh në emisione preferohet zgjidhja e problemit me mjete të dhunës. Edhe vetë "i miri" e mundë "të keqin" me mjete të dhunës. Ska rëndësi se cili "i miri" apo "i keqi" e përdorë dhunën, ajo është dhunë. Qëllimi që fëmiju i juaj të edukohet, që problemet t'i zgjidhë pa dhunë, duhet të kihen gjithmonë parasysh. Kjo më së miri arrihet nëse prindërit në prezencën e fëmijut i zgjidhin problemet pa dhunë .
- Programet komerciale dhe filmat shpesh ndërprehen për shkak të reklamave dhe në këtë rast zgjaten emisionet; e shpesh ndodhë që të ndërrohen programet sa këtu atje, këto ndryshime të programit e çojnë fëmijun në probleme koncentrimi. Reklama e ka vetëm një qëllim: shitjen e gjërave dhe të përfitojnë sa më shumë blerës. Spjegojuni fëmijëve se reklamat nuk janë emisione të pavarura.

- Është mirë që emisioni i pëlqyer të shikohet bashkarisht me fëmijën e vogël, me këtë rast ju e kontrolloni sjelljen e fëmijës ndaj emisionit. Nëse ata kanë pyetje apo frigohen nga ndonjë skenë, atëherë duhet që menjëherë të pergjigjeni apo ta largoni nga friga përmes sqarimit të ngjarjes. Pas filmit është mirë që t'ia mundësoni fëmijëve të flasin rreth filmit. Në këtë rast ju i ndihmoni fëmijët të largohen nga skena që për ta ishte e frigshme si dhe për anët pozitive të krijohen përshtypjet e mira.
- Fëmijët i interpretojnë rolet e filmit, kjo është e natyrshme. Ata i përjetojnë edhe skenat e rrahjes në film. Mirpo nuk duhet të ndalemi shumë rreth sajë. Përvoja dhe përjetimi i fëmijëve nga jeta reale (në familje, rrethin shoqërorë, qerdhe e shkollë etj.) si dhe zhvillimet emocionale luajnë rol të rëndësishëm në zhvillim të personalitetit të fëmijëve.
- Fëmijët duhet që së paku gjysëm ore pas përcjelljes së TV-së të pushojnë e pastaj të shkojnë në shtrat. Fëmijëve u duhet kohë që t'i përpunojnë skenat e përcjellura.
- Ju duhet të jeni të sigurtë që kujdestarët e fëmijëve (psh Gjyshja apo Gjyshi) i përmbahen rregullave të caktuara për të përcjellur programin televiziv. Nëse nuk jeni të sigurtë se ata i përmbahen rregullave, atëherë merrni masat e nevojshme.
- Keni kujdes që fëmijët të ulen mirë, në largësi të mjaftueshme dhe zëri i TV-së të jetë i ngritur në nivel të duhur. Fëmijët nuk guxojnë ta shikojnë TV-në në dhomë të fjetjes si dhe në pozitë të shtrirë.
- Fëmijët i shohin filmat që iu pëlqejnë. Me anë të videos mund t'i regjistroni ato filma në mënyrë që fëmijët t'i shikojnë me orarë të caktuar edhe më vonë.



## Shikimi i tepërt dhe i pakontrolluar i TV-së

- Fëmijët nuk mund ta bëjnë dallimin mes të vërtetës dhe fiksit dhe t'i përpunojnë përshtypjet e tyre. Ata mund të frigohen, pastaj mund të paraqiten pengesa gjumi e koncentrimi të ta. Spjegojuni atyre se çka është e vërtetë dhe çka është fiktion.
- Shpeshherë emisionet paraqesin klishe të "bardh e zi" (psh mashkujt janë të fortë, gratë të dobëta etj). Spjegojuni fëmijëve të vërtetën jetësore.
- Gjatë lajmeve ka skena lufte e dhune. Largojuni emisioneve që ju nuk e dini se çfarë skena vijnë.
- Emisionet që nuk kanë gjuhë të pastër e dëmtojnë zhvillimin e të folmes.
- Lëvizjet natyrale të nevojshme për fëmijë shpesh dëmtohen duke percjellur emisione të gjata. Kjo e çmotivon fëmijun për jetë. Jo emisionet sportive, por sporti i bën të shkathtë.
- Shikimi i tepërt i emisioneve televizive ndikojnë negativisht në zhvillim, në lojra të pavarura dhe në motivim të fëmijëve. Puna e pavarur, motivimi dhe dhënja e vullnetit për lojra në mënyrë të pavarur për moshën e fëmijëve janë të përshtatshme që më vonë të arrijnë në shkollë, punë profesionale etj.

Vërejtje: shikimi i TV-së nuk është e vetmja gjë që shkakton pengesa koncentrimi te fëmijët. Ka mundësi që të jenë edhe gjërat tjera që e shkakton këtë. Mirpo fëmijët e dobët në shkollë më së shpeshti janë pasojë e shikimit të tepërt të televizionit. Nëse femiu është në disa lëndë i dobët, atëherë duhet gjithsesi të bisedohet me keshilltarin për arsim.

- Shikimi i tepërt i TV-së mund ta çojë fëmijën gjer në mvarshmëri. Kjo dmth që njëkohësisht fëmiut nuk i mbetet kohë të kontaktojë me shoqërinë e cila është parakusht për t'i mësuar qëndrimet sociale, ku njëkohësisht jeton në rrethin e shoqërisë reale. Qëndrimi gjatë para TV-së e bën femiun te mërzitshëm, të paaftë për të qenë i pavarur etj.  
Perveq kësajë ndodhë edhe me familjet që shikojnë gjatë TV-në të kenë kontakte të pakta mes veti dhe krijohet përshtypja se ata kanë pak për t'i thënë njëri-tjetrit. Gjatë ngrërjes nuk bën të shikohet televizioni. Kjo kohë duhet të shfrytëzohet për komunikim brenda anëtarëve të familjes.

## **Frigat e mundshme dhe përfundimi i kënaqshëm i filmit**

- Në mosha të caktuara, fëmijët kanë dëshirë të shikojnë filma interesant. Ata dëshirojnë që frikën dhe mundin e tyre ta orientojnë. Kështu ata mësojnë se si të gjenden në situata frige në jetën e përditshme.



- Pyeteni fëmun e juaj pse një film interesant don ta shohë pastaj vendosni vetë se a duhet ta shohë femiu atë film/emision apo jo. Gjithësesi shikoni këto emisione bashkarisht, tregoni atijë (fëmiut) se si gjindeni ju në situatën e ngjashme.
- Në mënyrë që femijët t'i përpunojnë emisionet duhet të shikohen vetëm emisione që femijët mund t'i kuptojnë.
- Spjegojuni fëmijëve se skenat në film janë vetëm lojë. Nëse në skenë derdhet gjak, atëherë ju duhet tia bëni të qartë fëmijëve se ajo është ngjyrë apo kequr dhe se skena nuk ka të bëjë me realitetin. Ky veprim është më i drejtë sesa menjëherë ta fikni televizorin apo ta ndërroni programin, e me këtë sjellje ta lini fëmiun të vetëm me frigën dhe me nevojën për risi. Përmes shikimit të mëparshëm të programit javorë mund tui ikni këtyre skenave, edhe pse nuk mund tui ikni gjithmonë.
- Filmi që e ka një përfundim të mirë është për shpirtin e fëmiut shumë i rëndësishëm. Nëse nuk e ka një përfundim pozitiv (të mirë, të pëlqyer nga fëmiu) atëherë mundohuni që filmit tia jepni një karakter të tillë duke e analizuar atë bashkarisht.

## **Cilët filma, në cilën moshë preferohen të shikohen? Ku mund t'i merrni informacionet?:**

Videokasetat që prodhohen në Gjermani e kanë të shënuar se nga cila moshë mund të shikohet ajo. Mirpo aty s'ka informacione për kualitetin e filmit. Lidhur me këtë po ju ofrojmë disa adresa se ku mund të merrni filma për femije:

**Programmberatung für Eltern e.V.**  
**Postfach 801344, 81613 München**  
**Tel.: 089 – 63808-280**  
**www.flimmo.de**

Kjo shoqatë ka edhe fletushkën e vetë „Flimmo“ me të TV- programin për fëmijë në gjuhën gjermane.

**Stadtjugendamt München**  
**Jugendmedienschutz**  
**Streitfeldstraße 23, 81673 München**  
**Telefon 0 89/2 33 -3 32 67**  
**E-Mail daniela.obermair@muenchen.de**

**Bundeszentrale für politische Bildung**  
**Referat Medienpädagogik**  
**Postfach 2325, 53013 Bonn**  
**www.bpb.de**

**Bundesministerium für Familie,  
Senioren, Frauen und Jugend**  
**53107 Bonn**

## **Quellen / Literatura**

1. *“Kinder – schauen, hören, fühlen – Fernsehen”*  
Stadtjugendamt München
2. *“Fernsehen, Computer & Co. – Nichts für kleine Kinder?”*  
Bayerisches Staatsministerium für Arbeit und Sozialordnung, Familie und Frauen
3. *“Geflimmer im Zimmer”*  
Bundesministerium für Familie, Senioren, Frauen und Jugend
4. *“Nicht nur laufen lassen! – Kinder, Fernsehen und Computer.”* Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung, 51101 Köln

# Ku mund të këshilloheni?

Lidhur me

- Edukim
- Zhvillimin e fëmijëve
- Konfliktet familjare
- Problemet e ndarjes së bashkshortëve
- Vështirësitë në shkollë

## ZENTRUM

**Landeshauptstadt München  
Sozialreferat/Stadtjugendamt**

Reisingerstr. 10  
80337 München  
Tel.: 089-233 - 257 76

**Evang. Beratungszentrum  
München e.V./Diakonie**

Landwehrstr. 15 Rgb  
80336 München  
Tel.: 089-590 48 130

## Caritasverband

Herzogspitalstr.7  
80331 München  
Tel.: 089-260 62 45 - 46

**AWO Landesverband Bayern  
Psychologischer Dienst für  
MigrantInnen**

Goethestr. 53  
80336 München  
Tel: 089-544 247 - 53

## LEHEL

**Kath. Jugendfürsorge**

Unsöldstr. 15  
80538 München  
Tel.: 089-746 47 230 - 231

**PASING - OBERMENZING -  
ALLACH - UNTERMENZING**

**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Hillernstr. 1, 81241 München  
Tel.: 089-233 372 72

## LAIM - HADERN

**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Rushaimerstr. 2  
80689 München  
Tel.: 089-54 67 36 0 - 1

**NEUHAUSEN -  
NYMPHENBURG - MOOSACH**

**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Dantestr. 27, 80637 München  
Tel.: 089-166086

**HASENBERGL -  
FELDMOCHING**

**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Wintersteinstr. 12  
80933 München  
Tel.: 089-313 24 25

**Sozialer Beratungsdienst  
Hasenberg e.V. Diakonie**

Riemerschmidstr. 16  
80933 München  
Tel.: 089-31 20 96 - 0

## SCHWABING - FREIMANN

**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Haimhauser Str. 13  
80802 München  
Tel.: 089-39 10 14

## Haidhausen

**Verein-Schule-Beruf e.V./DPWW**  
Hochstr. 31, 81669 München  
Tel.: 089-48 88 26

## BOGENHAUSEN

**Caritasverband/Nebenstelle**  
Cosimastr. 123  
81925 München  
Tel.: 089-95 93 91 80

**ALTPERLACH -  
NEUPERLACH - TRUDERING**

**Ökumenische Beratungsstelle  
Caritas/Evang. Beratungs-  
zentrum**  
Lüderstr. 10, 81737 München  
Tel.: 089-67 82 02 24

→ → →

**RAMERSDORF - RIEM -  
KIRCHTRUDERING -  
BERG-AM-LAIM**  
**SOS Beratungs- und  
Familienzentrum**  
**SOS Kinderdorf e.V. / DPWV**  
St.-Michael-Str. 7  
81673 München  
Tel.: 089-43 69 08 0

**UNTERGIESING - HARLACHING**  
**Stadtjugendamt/Nebenstelle**  
Oberbibberger Str. 45  
81547 München  
Te.: 089-699 23 55 - 59

**FORSTENRIED -  
FÜRSTENRIED - SOLLN**  
**Caritas/Nebenstelle**  
Königwieserstr. 12  
81475 München  
Tel.: 089-755 92 50

**(NEU-)AUBING -  
LANGWIED - LOCHHAUSEN**  
**Pro Familia/DPWV**  
Bodenseestr. 226  
81243 München  
Tel.: 089-897 67 30

**MILBERTSHOFEN**  
**AWO KV München-Stadt /  
Verein**  
**Stadtteilarbeit Milbertshofen**  
Georgenschwaigstr. 27  
80807 München  
Tel.: 089-35 65 15 03

[www.flimmo.de](http://www.flimmo.de)

